



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.7, datë 10.09.2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “TIRANA BUSINESS PARK” SH.P.K., ME VENDNDODHJE: BASHKIA VORË, QARKU TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të subjektit “Tirana Business Park” sh.p.k., me vendndodhje: Bashkia Vorë, Qarku Tiranë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- $X = 475410.7$
 - $Y = 4586207.8$
 - $Z = 31 \text{ m}$

 - Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}} = 5 \text{ l/sek}$

 - Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 4 \text{ l/sek}$

 - Qëllimi i përdorimit : Për qëllime të ndryshme (sanitare) në funksion të kompleksit rezidencial

 - Thellësia e pus-shpimit: 55 m

 - Thellësia e vendosjes së pompës : 30 m

 - Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

 - $X = 475689.3$; $Y = 4585795.3$; $Z = 33 \text{ m}$

 - Trupi ujqor pritës: Impjant trajtimi
3. Shfrytëzimi të mos jetë më shumë se 12 orë në ditë;
4. Shfrytëzimi i ujit të dy puseve të mos bëhet njëkohësisht, por në mënyrë të alternuar;
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL ISHËM

EMILJAN JANI

